



## GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:023664

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06546905

### K.DH.Shk II.nr.661/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi në çështjen përmbaremore të kreditorit Komuna e Kaçanikut, me seli në Kaçanik, Rr. Qamil Ilazi pn. kundër debitorit Unio Commerce Sh.p.k. me numër unik identifikues 810308454 seli në Doganaj, Rr. Ahmet Kaçiku – Komuna e Kaçanikut, me pronar Z.B. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Daut Rudi me seli të zyrës në Kaçanik, me bazë juridike përmbaremore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1962/22 të datës 16.05.2023, me datë **02.12.2024**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna e Kaçanikut, me seli në Kaçanik, Rr. Qamil Ilazi pn., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1962/22 të datës 16.05.2023, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1962/22 të datës 16.05.2023, në pikën I të dispozitivit Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit Unio Commerce Sh.p.k, në pikën II shfuqizohet Urdhri Përmbaremore P.nr.01/2022 të datës 05.01.2022 i lejuar nga Përmbareuesi Privat Sheremet Livoreka me seli të zyrës në Ferizaj. Dhe në pikën III detyrohet kreditorin Komuna e Kaçanikut, me seli në Kaçanik, Rr. Qamil Ilazi pn. që të bartë shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë të përmbaremit, përfshirë shpenzimet e debitorit për përpilimin e prapësimit sipas Tarifës zyrtare për Avokatë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për

Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1962/22 të datës 16.05.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomik duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Kaçanikut datën 01/2022 ka bere propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës me nr. 3354703871 datë 05.01.2021 për tatimin e vlerësuar për vitin 2021 dhe borxhet e akumuluar dhe të papaguara të tatimit në shumën e përgjithshme 103'149.90€ (njëqind e tre mijë e njëqind e dyzet e nëntë euro e nëntëdhjetë cent), me kamatëvonesë në lartësi 8%, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, përfshirë edhe shpenzimet e shkaktuara në procedurë përmbartimore. Debitori në kundërshtimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se dokumenti mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura përmbartimore nuk i gëzon cilësitë e dokumentit të besueshëm siç është përcaktuar në nenin 29 të Ligjit për procedurën e përmbartimit (LPP), sepse fatura tatimore është lëshuar për vitin 2021 për shumën 3'329.21 euro ndërkaq me përmbartim kërkohet shuma në lartësi 103'149.90€. Tutje ka shtuar s enë faturën ën fjalë nuk janë dhënë as elementet e kërkueshme nga neni 29 par. 3 i LPP-së, se në çka konsiston borxhi i kërkuar në këtë faturë tatimore. Për fund ka theksuar se sa i përket tërësisë së detyrimit konform me nenin 71 par. 1.4 të LPP-së ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbartimi. Duke i propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi si i bazuar, të shfuqizohet urdhri përmbartimor P.nr.01/2022 të datës 05.01.2022 si dhe të obligohet kreditori që të mbulojë shpenzimet e shkaktuara në procedurë përmbartimore, përfshirë shpenzimet e përpilimit të prapësimit.

Kreditori i çështjes ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi në tërësi si i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka fakte për pa bazueshmërinë të vendimit përmbartimor. Po ashtu lidhur me skadimin e kohës për të kërkuar borxhin tatimor në të cilin është thirrur debitori, kreditori ka theksuar se palët ndërgjyqës kanë pasur marrëveshje për përmbushje të detyrimeve tatimore mirëpo debitori nuk i ka përmbushur asnjëherë detyrimet e tija nga marrëveshja që kishte lidhur me kreditorin. Për këtë i ka prezantuar gjykatës edhe kopje të marrëveshjes përkatëse.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar,

duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë ka bere vlerësimin e faturës tatimore nr. 3354703871 datë 05.01.2021 konform dispozitës ligjore nga neni 29 par. 3 lidhur me nenin 38 par. 1 të Ligjit për procedurën e përmbartimit (LPP). Neni 29 par. 3 i LPP-së përcakton faturën si dokument të besueshëm mbi bazën e të cilit mund të iniciohet procedura përmbartimore për realizimin e kërkesës në të holla, Ndërkaq me nenin 38 par. 1 të LPP-së përcaktohet se: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit.”

Tutje gjykata e shkallës së parë duke iu referua Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 27 të saj i cili përcakton se “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”, ndërsa me nenin 30, par.1 të këtij ligji përcaktohet se “Nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën (300) Eurove.”. Ndërsa, neni 30, par.7 i këtij ligji parasheh se “Brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara, autoriteti që ka marrë vendimin kërkon autoritetit kompetent përmbartues përmbartimin e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbartimore. Një kopje e propozimit për përmbartim së bashku me dokumentet e bashkëlidhura i dërgohen menjëherë debitorit”.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës tatimore ku me dispozitën e nenit 29 par. 3 lidhur me nenin 38 par. 1 të Ligjit për procedurën e përmbartimit (LPP). Neni 29 par. 3 i LPP-së përcakton faturën si dokument të besueshëm mbi bazën e të cilit mund të iniciohet procedura përmbartimore për realizimin e kërkesës në të holla, Ndërkaq me nenin 38 par. 1 të LPP-së përcaktohet se: “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit. E në rastin konkret kreditori propozimin për përmbartim i ka bashkangjitur Faturës me nr.

3354703871 datë 05.01.2021, por që në shkresat e lëndës mungon vendimi mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore, të cilit dokument me ligj të veçantë i është njohur cilësia e dokumentit përmbarues për arkëtimin e detyrimeve tatimore, kjo në përputhje me nenin 22, par.1, nën-par. 1.9 të LPP-së i cili parasheh mundësinë që si dokument përmbarues të shërbej edhe dokumenti të cilit me ligj të veçantë i është njohur atributi i tillë. ]

Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 27 të saj i cili përcakton se “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”, ndërsa me nenin 30, par.1 të këtij ligji përcaktohet se “Nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën (300) Eurove.”. Ndërsa, neni 30, par.7 i këtij ligji parasheh se “Brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara, autoriteti që ka marrë vendimin kërkon autoritetit kompetent përmbarues përmbarimin e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbarimore. Një kopje e propozimit për përmbarim së bashku me dokumentet e bashkëlidhura i dërgohen menjëherë debitorit”. Andaj në mungesë të vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore siç përcaktohet me nenin 30, par.7 të Ligjit për tatimin mbi pronën e paluajtshme, edhe prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, par.1.1 i cili përcakton se “Prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: Dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarushmerise

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së dytë duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt si fatura si dokument i besueshëm, nuk është e papërshtatshme për përmbarim pasi në faturë tatimore totali për pagesë në shumën e përgjithshme nuk i përgjigjet periudhës tatimore për të cilën është lëshuar përmbarimi, pasi që si datë e lëshimit të faturës është data 05.01.2021 për lartësinë tatimore të vlerësuar të shumës dhe e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i

besueshëm për përmbardim në kuptim të dispozitës së nenit 22, par.1, nën-par. 1.9 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.661/24, me datë 02.12.2024**

**Gjyqtari**  
**Ramush Bardiqi**